

18 qershor 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 18.06.2026, Prishtinë

Korniza për menaxhimin e konfliktit të interesit në FBK


Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti, gjegjësisht neni 24, dhe bazuar në Kodin Etik të FBK-së, pas shqyrtimit të propozimit nga Sekretarja e Përgjithshme, me datë 18.06.2026, Bordi i FBK-së vendos si në vijim:

1. Miratohet korniza zbatuese dhe dokumentet për menaxhimin e konfliktit të interesit, si në vijim:
 - Formulari për deklarimin e interesave dhe konflikteve të mundshme të interesit;
 - Formulari për deklarim e interesave ad-hoc (nëse aplikohet në mbledhje);
 - Regjistri i konflikteve të interesit.
2. Të gjithë anëtarët e Bordit, komisioneve dhe stafi ekzekutiv obligohen të plotësojnë formularin përkatës dhe ta përditësojnë atë sa herë që ndryshojnë rrethanat relevante dhe së paku një herë në vit.
3. Krijohet regjistri i konflikteve të interesit i FBK-së, i cili mbahet dhe administrohet në mënyrë të centralizuar. Për administrimin e regjistrit caktohet Asistentja Ekzekutive e FBK-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe obligon të gjitha strukturat relevante të FBK-së.
5. Zbatimi fillon fillimisht në Zyrën Ekzekutive, përpara shtrirjes së plotë në të gjitha organet e FBK-së.
6. Për zbatimin e kësaj kornize përgjegjëse është Zyra Ekzekutive, nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kryetarit.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

